

SYLLABUS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi:	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës:	Menaxhimi i Sistemit Informativ-MSI
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	O
Viti i studimeve:	II
Semestri:	IV
Numri orëve në javë:	3
Vlera në kredi – ECTS:	4
Koha / lokacioni:	UShAF
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë synon të ofrojë një kuptim të thelluar dhe të strukturuar mbi menaxhimin e sistemeve informative dhe rolin strategjik të inteligjencës artificiale (IA) në zhvillimin e bizneseve moderne. Ajo eksploron ndërveprimin ndërmjet teknologjisë dhe menaxhimit, me fokus të veçantë në ndikimin e teknologjive të avancuara në vendimmarrjen strategjike, rritjen e efikasitetit operacional dhe forcimin e konkurrencës në treg. Gjatë kursit, studentët do të pajisen me njohuri të rëndësishme mbi sistemet e informacionit, strategjitë organizative dhe integrimin e këtyre sistemeve në praktikën menaxheriale. Temat përfshijnë rrjetet dhe internetin, e-biznesin, menaxhimin e marrëdhënieve me klientët (CRM), bazat e të dhënave, sigurinë e informacionit, si dhe përdorimin e teknologjive të reja në menaxhimin e projekteve dhe proceset vendimmarrëse. Lënda synon të përgatisë studentët për të aplikuar këto koncepte në mënyrë praktike, duke kontribuar në përmirësimin e performancës organizative dhe sigurimin e qëndrueshmërisë në një mjedis gjithnjë e më të digjitalizuar dhe global.
Qëllimet e lëndës	Qëllimi i kësaj lënde është të pajisë studentët me njohuri të avancuara mbi rolin strategjik të sistemeve informative dhe ndikimin transformues të inteligjencës artificiale (IA) në menaxhimin e organizatave moderne. Përmes një qasjeje të integruar teorike dhe praktike, lënda synon të zhvillojë aftësitë e studentëve në përdorimin efektiv të teknologjive të reja për të rritur efikasitetin operacional, përmirësuar proceset e vendimmarrjes dhe adresuar sfidat që lidhen me transformimin digjital. Në fokus janë gjithashtu analizimi i çështjeve etike dhe ndikimi i teknologjisë në qëndrueshmërinë organizative. Studentët do të zhvillojnë kompetenca në aspektet teknike dhe menaxheriale të sistemeve informative, përfshirë bazat e të dhënave, përpunimin dhe analizimin e të dhënave për qëllime strategjike, duke i aftësuar ata të kontribuojnë në ruajtjen e konkurrueshmërisë në një treg dinamik dhe global.

Rezultatet e pritura të mësim-nxënies	Pas përfundimit të kësaj lënde studentët do të: 1. Analizojë dhe vlerësojë ndikimin strategjik të sistemeve informative dhe teknologjive të avancuara (si AI, Big Data, Cloud Computing) në rritjen e performancës dhe konkurrueshmërisë së organizatave. ECTS: 0.60 2. Zbatojë zgjidhje teknologjike duke përdorur inteligjencën artificiale për të adresuar sfida të biznesit, të përmirësojë efikasitetin operacional dhe të mbështesë procesin e vendimmarrjes. ECTS: 0.80 3. Zhvillojë strategji efektive të menaxhimit të sistemeve informative, duke i përafruar ato me qëllimet dhe strategjitë e përgjithshme të biznesit. ECTS: 0.70 4. Përvetësojë aftësi teknike dhe menaxheriale për projektimin, mbikëqyrjen dhe përmirësimin e sistemeve informative në organizata të ndryshme. ECTS: 0.60 5. Reflektojë në mënyrë kritike mbi çështjet etike dhe sociale të lidhura me përdorimin e teknologjisë në biznes, duke përfshirë privatësinë, sigurinë e të dhënave dhe përgjegjësinë sociale. ECTS:50 6. Tregojë aftësi për punë në ekip dhe bashkëpunim ndërdisiplinor, për të kontribuar në zhvillimin dhe menaxhimin efektiv të projekteve të sistemeve informative. ECTS:0.80
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë/Vizitë praktike	5	1	5
Kontaktet me mësimdhënësit – konsultimet	1	2	2
Përgatitja për detyra projekte	1	5	5
Projekt kursi – Test (planifikim + zbatim)	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	2	2
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			20
Përgatitja përfundimtare në provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	1	2	2
Projektet, prezantimet etj	1	5	5
Totali			100

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësim-nxënies	Kursi zhvillohet gjatë një periudhe 15-javore, me 3 orë leksione dhe/ose ushtrime çdo javë, të organizuara si individualisht ashtu edhe në grupe. Ushtrimet synojnë të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve në diskutime mbi shembuj konkretë, duke thelluar njohuritë teorike dhe praktike. Pjesëmarrja e rregullt dhe kontributi aktiv në leksione dhe ushtrime përbëjnë një komponent kyç të kursit, duke u konsideruar thelbësor për zhvillimin e aftësive kritike, analitike dhe bashkëpunuese të studentëve. Studentët inkurajohen të angazhohen në diskutime, të ndajnë
--	--

	ide dhe të punojnë në bashkëpunim për të ndërtuar një kuptim më të plotë të koncepteve të trajtuara. Metodika e kursit kombinon: • Leksione teorike për të prezantuar koncepte dhe parime bazë dhe të avancuara. • Ushtrime praktike për të zbatuar konceptet në situata reale. • Analizë të studimeve të rasteve për të lidhur literaturën me praktikën më të mira. • Punime seminarike dhe detyra të strukturuar për zhvillimin e aftësive kërkimore dhe prezantuese. • Vlerësime periodike për të matur progresin dhe nivelin e përvetësimit të njohurive. Materialet mësimore do të paraqiten në formate audio-vizuale duke përdorur teknologji moderne, duke përfshirë programet Windows Office dhe mjete të tjera dixhitale mbështetëse. Në aspektin teorik, kursi ofron njohuri të bazuara në literaturën më të fundit shkencore, ndërsa pjesa praktike përqendrohet në zbatime konkrete, analiza rastesh nga praktika ndërkombëtare dhe zgjidhjen e detyrave analitike me interpretim të rezultateve. Ky kombinim synon të krijojë një mjedis interaktiv që forcon bashkëpunimin midis profesorëve dhe studentëve, si dhe midis vetë studentëve, duke rritur cilësinë e të nxënies dhe aftësinë për të aplikuar njohuritë në situata reale biznesi..
Metodat e vlerësimit dhe kriteret e kalueshmërisë	Metoda e vlerësimit – mbështetet në tri aktivitete – në bazë të të cilave do të ndërtohet nota përfundimtare: ➤ Aktivitetet dhe Angazhim në mësim.....max 20 pikë (%), ➤ Hartimi / prezantimi i projektit/punim seminarial..max 10 pikë (%), ➤ Provimi final (ose nga dy teste).....max 70 pikë (%), Kriteret e kalueshmërisë - ndërlidhur me aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit: 1. Aktiviteti dhe Angazhimi në mësim – vlerësohet me 20 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme: • Aktiviteti në mësim (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të jetë aktive dhe i përfshirë në diskutime interaktive profesor-studentë, studentë-studentë, duke hapur tema të reja që janë të ndërlidhura me lëndën, duke dhënë ide, opinione, mendime kritike me qëllim të nxitjes së debatit gjatë ligjëratave. • Angazhimi (10 pikë (%)) - nënkupton që studenti të kryejë dhe prezantojë detyrat që caktohen në fund të secilës ligjëratë dhe pastaj diskutohen në fillim të ligjëratës vijuese. Qëllimi: Nxitja e mendimit kritik dhe zgjidhja kreative e situatave reale ndërlidhur me problemet e parashtruara - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulën e lëndës. 2. Hartimi dhe prezantimi i një projekti/punimi seminarial - vlerësohet me 10 pikë nga 100 pikët (%) e mundshme, Brenda semestrit studenti (mund të jetë një grup i studenteve – jo më shumë se 3 studentë) duhet të përgatitë një projekt/punim seminarial (Word dhe në PowerPoint), i njëjti punim duhet të prezantohet gjatë orëve të caktuara për prezantim. Prezantimi do të zgjasë më së shumti

15 minuta.

Tema e punimit mund të propozohet nga profesori dhe nga studenti – tema e propozuar nga studenti duhet të miratohet nga profesori, dhe e njëjta duhet të jetë në korrelacion të plot me lëndën.

Punimi prezantohet para grupit dhe vlerësohet në bazë të cilësisë së përmbajtjes, analizës, kreativitetit dhe aftësisë për ta prezantuar qartë.

Kriteret e vlerësimit të projektit/punimit seminari	
Komponenti	Pikët (%)
Struktura dhe Qëllimi i punimit	3
Përmbajtja/shtjellimi i punimit	4
Përfundimet e nxjerra dhe prezantimi i punimit	3
Gjithsej:	10

Qëllimi: zhvillimi i aftësive kërkimore, analitike dhe shkencore, përmes trajtimit të një teme të caktuar në mënyrë të pavarur dhe akademike - të ndërlidhura me mësim-nxënien në modulin e lëndës.

3. Testi i provimit final, vlerësohet me 70 pikë (%) nga 100 pikët (%) e mundshme,

Brenda semestrit parashihet të mbahen dy Teste (2 x 35 pikë (%)) për studentët e angazhuar aktiv me pjesëmarrje në ligjërata, testi i parë në javën e 7 ose të 8 dhe testi i dytë në fund të ligjëratave, studenti e kalon testin nëse ka min 18 pikë (%), pasi që studenti vlerësohet se ka kaluar testin e parë, atëherë studenti mund t'i nënshtrohet testit të dytë studenti ka të drejtë të nënshtrohet drejtpërdrejt provimit final - me gojë ose me shkrim. Studenti do t'i nënshtrohet testit të provimit final, pas përfundimit të ligjëratave të lëndës dhe në afatet e provimeve të përcaktuara nga senati i Universitetit.

Qëllimi i provimit është që të vlerësohet njohuria, aftësia, shkathtësia dhe kompetencat e studentit, ndërlidhur me rezultatet e mësim-nxënies të parapara në materialin e lëndës së ligjëruar.

Testi i provimit (formulari me pyetje) duhet të plotësohet në mënyrë individuale nga studenti dhe i njëjti vlerësohet sipas kriterëve dhe përmban:

- ♦ pyetje objektive me zgjedhje të shumëfishta alternative, të njëjtat do të shfrytëzohen për të vlerësuar aftësitë e studentit për të rikujtuar dhe njohur konceptet dhe materialin e lëndës.....**30 pikë (%)**,
- ♦ pyetje subjektive të llojit tema për shpjegim/përgjigje me shkrim/detyra - për të cilat vet studenti duhet të jetë në gjendje të jep përgjigje ndërlidhur me materialin e lëndës së ligjëruar, të njëjtat përgjigje do të shfrytëzohen për të vlerësuar të kuptuarit dhe aftësitë e studentit për të zbatuar njohuritë e fituara në analizë, sintezë/vlerësim të problemit....**40 pikë (%)**

Qëllimi i testit: të vlerësojë përvetësimin e rezultateve të mësim-nxënies dhe aftësinë për t'i zbatuar ato në situata praktike.

Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pikë (%) nga të gjitha aktivitetet e parapara me metodën e vlerësimit,

Notat në UShAF:

		Nota	ECTS/Nota	Përqindja (%)	Përkufizimi
		10	A	90 - 100	Shkëlqyeshëm
		9	B	80 - 89	Shkëlqyeshëm
		8	C	70 - 79	Shumë mirë
		7	D	60 - 69	Mirë
		6	E	50 - 59	Mjaftueshëm
		5	FX/F	0 - 49	Pamjaftueshëm
Mjetet e konkretizimit – TI	Përdorimi i SMART-tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, Përdorimi i platformave dhe mjeteve “on-line” për të mbështetur komunikimin dhe bashkëpunimin në ekip, etj.				
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	Struktura e këtij moduli është ndërtuar në bazë të një balancimi të kujdesshëm ndërmjet komponentës teorike dhe asaj praktike, me synim që të sigurohet një përvojë gjithëpërfshirëse dhe efektive. Qasja e integruar synon që studentët fillimisht të ndërtojnë një bazë të qëndrueshme konceptuale, për t'i mundësuar më pas zbatimin e dijes në kontekste praktike dhe situata të afërta me realitetin profesional. Në këtë drejtim, moduli është strukturuar sipas raportit 60% teori dhe 40% praktikë, si vijon: • 60 orë (60%) janë të dedikuara për ligjërata teorike, përmes të cilave studentët fitojnë njohuri mbi konceptet themelore të menaxhimit, qasjet teorike, metodologjitë bashkëkohore dhe standardet profesionale, të gjitha të reflektuara në përmbajtjen modulare. • 40 orë (40%) janë të orientuara drejt aktiviteteve praktike, duke përfshirë: • Ushtrime në klasë, Analiza të rasteve konkrete, Punë në grup dhe zhvillim projektsh simulimi, Kuize tematike dhe reflektime të strukturuar në fushën e menaxhimit. Në përputhje me këtë strukturë orësh, edhe shpërndarja e 4 ECTS bëhet në mënyrë proporcionale: • 2.4 ECTS (60%) i dedikohen përmbajtjes teorike, e cila përqendrohet në ndërtimin e njohurive akademike dhe kuptimit të thellë të tematikave të menaxhimit. • 1.6 ECTS (40%) i dedikohen përmbajtjes praktike, duke i orientuar studentët drejt zhvillimit të aftësive analitike, praktike dhe të mendimit kritik përmes aplikimit të koncepteve në raste konkrete. Kjo ndarje përfaqëson një model bashkëkohor të integritetit të teorisë me praktikën dhe synon të përgatisë studentët në mënyrë gjithëpërfshirëse për sfidat profesionale në fushën e menaxhimit.				
Literatura					
Literatura bazë	1. Laudon, K. C., & Laudon, J. P. (2021). „<i>Management Information Systems: Managing the Digital Firm</i>” (17th ed.) Edition, Global Edition. Pearson Education Limited. 2. Turban, E., Pollard, C., & Wood, G. (2021). „<i>Information Technology for Management: Driving Digital Transformation to Increase Local and Global Performance, Growth and Sustainability</i>”, (12th Edition). Publisher: John Wiley & Sons				

	3. Mirdaim Axhami, PhD (2014), „Menaxhimi i sistemeve të informacionit”, Tiranë
Literatura shtesë	1. Russell, S., & Norvig, P. (2021). „Artificial Intelligence: A Modern Approach” (4th Edition).Publisher:Pearson. 2. Davenport, T. H., & Ronanki, R. (2018). „Artificial Intelligence for the Real World, Harvard Business Review”.
<i>Informacion shtesë</i> – Punimi Shkencor nga profesori i lëndës:	A. Loku & N. Loku; Paper; “Management Optimizing Healthcare Delivery through Advanced Information System Management: A Financial and Operational Perspective for Kosovo's Healthcare Sector”, 2024, Journal: Pakistan Journal of Life and Social Sciences; E-ISSN: 2221-7630; P-ISSN: 1727-4915 Linku i punimit: https://www.pjlss.edu.pk/pdf_files/2024_2/878-892.pdf
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë	Prezantimi i syllabusit të lëndës: qëllimet, metodologjia dhe vlerësimi. Çfarë është një sistem informacioni? Përkufizimi dhe rëndësia e tij në ekonominë globale. Rezultati i pritur nr. 1, 3 & 5
Java e dytë	Strategjia organizative dhe menaxhimi i sistemeve të informacionit. E-Biznesi global dhe teknologjia në biznes. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 & 6
Java e tretë	Hyrje në inteligjencën artificiale (IA); Roli i sistemeve të informacionit në ndërmarrje dhe strategji biznesi. Efektet e IA në organizim dhe sjellje. Projektimi dhe përshtatja e sistemeve të informacionit me nevojat e biznesit. Strategjitë teknologjike për të përballuar konkurrencën dhe përafrimi i TI-së me qëllimet e organizatës. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 & 4
Java e katërt	Inteligjenca artificiale në biznes; Aplikimi i IA në automatizimin dhe vendimmarrjen e biznesit. Çështjet etike dhe sociale në sistemet e informacionit. Modeli për analizimin e sfidave etike, sociale dhe politike. Pesë dimensionet morale të epokës së informacionit dhe ndikimi i tyre. Tendencat teknologjike që sjellin çështje etike në fokus. Rezultati i pritur nr. 2, 4, dhe 5
Java e pestë	Roli i Teknologjisë së Informacionit në Përmirësimin e Kujdesit Shëndetësor; Transformimi digjital në shëndetësi. Përparimet teknologjike si inteligjenca artificiale dhe sistemet e integruara. Mjedis modern teknologjik në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve shëndetësore. Literatura: A. Loku & N. Loku; Paper: „Management Optimizing Healthcare Delivery through Advanced Information System Management: A Financial and Operational Perspective for Kosovo's Healthcare Sector” 2024 Rezultati i pritur nr. 1, 3, 5, dhe 6
Java e gjashtë	Bazat e Inteligjencës së biznesit dhe menaxhimi i informacionit; Konceptet bazë të organizimit të dosjeve dhe strukturave të të dhënave. Sistemet e menaxhimit të bazës së të dhënave (DBMS) dhe roli i tyre në biznes. Bazat e të dhënave jo-relacionale, përdorimi i bazave të të dhënave cloud dhe

	teknologjisë blockchain. Sfidat e të dhënave të mëdha dhe rëndësia e tyre për vendimmarrje. Metodat për sigurimin e cilësisë dhe saktësisë së të dhënave. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3, dhe 6
Java e shtatë	Testi i pare,
Java e tetë	Tendencat e teknologjisë dhe aplikimet praktike; Aplikimi i teknologjive. Rast studimi: Analizë praktike e implementimit të një teknologjie specifike në një organizatë të përzgjedhur. Vlerësim dhe reflektim: Diskutim mbi përfitimet dhe sfidat e përdorimit të teknologjive të reja. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3, 5 dhe 6
Java e nëntë	Siguria e sistemeve të informacionit, diskutim interaktiv: Identifikimi i kërcënimeve dhe masave për adresimin e tyre. Rast studimi: Analizë e një rasti real mbi shkeljet e sigurisë dhe mësimet e nxjerra. Ese dhe reflektim: Studentët paraqesin zgjidhje inovative për çështjet e sigurisë në sisteme. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 4 dhe 6
Java e dhjetë	Sistemet informative dhe të dhënat për nevoja statistikore dhe krahasuese; Roli i Sistemeve Informative në analizën statistikore. Aplikimet kryesore, identifikimin e trendeve dhe vendimmarrjen strategjike. Krahasimi i performances së organizatës me standardet e industrisë dhe konkurrencës. Rezultati i pritur nr. 1, 3, 5 dhe 6
Java e njëmbëdhjetë	Marrja e vendimeve duke u bazuar në sistemet e informacionit; Marrja e vendimeve të bazuara në të dhëna: Analiza e roleve të sistemeve të informacionit në proceset vendimmarrëse. Modelet e vendimmarrjes: Diskutim mbi modele të ndryshme dhe përdorimin e analitikës për mbështetje. Përdorimi i inteligjencës artificiale: Implementimi i mjeteve IA për të përmirësuar proceset strategjike të vendimmarrjes. Rezultati i pritur nr. 1, 2, 3 dhe 6
Java e dymbëdhjetë	Trendët zhvillimore në teknologjinë informative dhe ndikimi i tyre në biznes; Tendencat kryesore në teknologjinë informative. Ndikimi në biznes, Rritja e qëndrueshmërisë teknologjike: Integrimi i teknologjive të gjelbra dhe praktikave të qëndrueshme në operacionet e biznesit. Përdorimi i teknologjisë për inovacion: Strategji për adaptimin e teknologjive të reja për të qëndruar konkurrues në tregun global. Rezultati i pritur nr. 1, 3, 4 dhe 5
Java e trembëdhjetë	Menaxhimi i informatave në sektorin shëndetësor dhe AI: Korniza konceptuale, Interpretimi i funksioneve në menaxhimin e informacionit shëndetësor, Sistemi elektronik i ofrimit të kujdesit shëndetësor, përfitimet e sistemeve të ofrimit të kujdesit shëndetësor, përmirësimi i cilësisë së kujdesit përmes menaxhimit të duhur të Informacionit elektronik shëndetësor Literatura: A. Loku & N. Loku; Paper: „<i>Management Optimizing Healthcare Delivery through Advanced Information System Management: A Financial and Operational Perspective for Kosovo's Healthcare Sector</i>” 2024 Rezultati i pritur nr. 1, 4, 5 dhe 6
Java e katërbëdhjetë	Diskutim dhe prezantim: Prezantim nga studentët i punimeve të tyre seminarike ose eseve mbi tema të lidhura me përdorimin e SI për analizë statistikore. Rast studimi: Analiza e një organizate reale që përdor të dhëna për të përmirësuar proceset dhe performancën. Rezultati i pritur nr. 1, 2, dhe 6
Java e pesëmbëdhjetë	Test 2, përgatitje Provimi përfundimtar

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes

Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në ligjëratat dhe ushtrime është e obligueshme. Gjatë orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve NDALOHET ushqimi, pëshpërimat që pengon punën në klasë dhe përdorimi i telefonave mobil. Njëkohësisht, telefonat celularë duhet të fiken ose të vihen në heshtje dhe të mos përdoren gjatë kohës së ligjëratave apo ushtrimeve. Mungesa e integritetit akademik (ku përfshihet plagjiatura, kopjimi i punës së një personi tjetër, përdorimi i ndihmave të paautorizuara në provime, mashtrimi etj) nuk do të tolerohet. Nëse ka dyshime për vërtetësinë e punës së paraqitur, mësimdhënësi ka të drejtë t'i kërkojë studentit të verifikojë punën e tij/saj. Kjo mund të bëhet përmes: përsëritjes së punës, testimit me shkrim ose me gojë, kuiz i papritur apo me çdo veprim tjetër që konsiderohet i nevojshëm nga ligjëruesi.